



Procesverbal 11/2023

I mbajtur në mbledhjen e XI-të të Komitetit për Komunitete, në Kryesimin e z.Osman Eminit - Kryesues i Komitetit për komunitete, mbledhja u mbajt me datën 27.11.2023 në ora 14. 00 në zyrën e takimeve të Kryetari i komunës.

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Komitetit për komunitete;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të Komitetit për Komunitete;
4. Raportimi i Drejtorit të Infrastrukturës lidhur me Infrastrukturën e propozuar më herët nga Komiteti për komunitete në Lagjet që janë vizitu dhe rekomandu nga Komiteti për komunitete dhe
5. Të ndryshme.

Pika 1

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Konfirmoi pjesëmarrjen në mbledhje – Prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete dhe OSBE-ja, Jeton Lika.

Pika 2

U Miratua rendi i ditës pa ndonjë vërejtje;

Pika 3

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

Pika 4

Nazim - Është një projekt i shpallur për përmirësimin e rrugëve dhe rrugicave, disa kanë filluar, disa kanë përfunduar.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Shpalosi disa fotografi ku është punuar në rrugë nga rekomandimet.

Brahim Osmani – Është mirë kur vijnë drejtorët për raportim, të vijnë të kompletohen raporte konkrete.

Flora Abdullahu - Me kriju një rrethanë për të liruar rrugët nga veturat që parkojnë vend pa vend. Disa nga rrugët janë: “Ahmet Hoxha” dhe rrugë të tjera që lidhen në afërsi të shkollave po ashtu edhe nxënësit e Fshatit Dubravë rrugës deri në shkollë të Zaskokut kanë rrezikshmëri të rrugës dhe kjo çështje duhet të rregullohet.
Të keni një informacion cila Drejtori merret me këtë çështje.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Të vendoset një pasqyrë për rrugën “Ejup Statovci” në afërsi të farkatarit (retrovizor), dhe pjesë të tjera që e kanë të njejtën problem.

Pika 5

Të ndryshme;

Flora Abdullahu – Të shkruhen kërkesa nga secili nga ne për takimet e radhës që të jemi me korrekt.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Të bëhet planifikimi i pikave të rendit të ditës, si dhe të bëhet caktimi i datës së mbledhjes.
Në takimin e radhës të ftohen Drejtorët Meriton Hajdini, Arben Halili.

Flora Abdullahu – Lutem që të vijnë për t’i dërguar kërkesat tona.

Takimi i radhës planifikohet të jetë me 14 Dhjetor në ora 10⁰⁰.

Procesmbajtësi

Xh. Jashari
Xhemajl Jashari

Kryesues i Komitetit për Komunitet
Osman Emini
Osman Emini

